REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2022:147734
Datë:	26.03.2024
Numri i dokumentit:	05504219

Ac.nr.399/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Buar Muzaqi dhe Liridon Maloku, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. M. nga fshati P. i Epërm, Komuna e Klinës, të cilin e përfaqëson avokatura " Krasniqi-Partners", me avokatë Xh.. K. dhe I. N., nga Prishtina adresa Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.58, Ulpianë-Prishtinë, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS, Sh.a, me seli në Prishtinë, nën-Distrikti në Klinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Granit Gërvalla, jurist i diplomuar në Zyrën Ligjore në Distriktin e Pejës në KEDS, me objekt kontesti kthim në vendin e punës dhe kompensim i të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.244/22, të datës 16.12.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË ankesa e paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS, Sh.a, me seli në Prishtinë, nën-Distrikti në Klinë, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.244/22, të datës 16.12.2022, si e PALEJUESHME.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.244/22, të datës 16.12.2022, ka vendosur si në vijim: REFUZOHET kërkesa e të paditurës KEDS-i që Gjykata Themelore Pejë – Dega në Klinë të shpallet, si gjykatë JO KOMPETENTE vendore – territoriale, për të vendosur në këtë çështje juridiko – kontestimore, që udhëhiqet me shenjën C.nr. 244/22. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi kjo Gjykatë do të vazhdojë procedurën sipas planit të punës dhe orarit të rregullte në këtë çështje.

2023:021647

Kundër këtij aktvendimi, e paditura përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke mos përmendur shkaqet e parapara me ligj për paraqitjen e ankesës, me pretendimet se e paditura me përgjigje ën padi si edhe në seancën e mbajtur konsideron se Gjykata Themelore ën Pejë, Dega në Klinë nuk është kompetente për shqyrtimin dhe procedimin e çështjes që i është paraqitur duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1 të LPK-së, me propozim që ankesa e të paditurës të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të prishet dhe vendoset për çështjen në gjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet e të paditurës si të pa bazuara, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e palejueshme.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 20.07.2022, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kthim në punë dhe kompensim të të ardhurave personale, me pretendimet se e paditura përmes Vendimit me nr. protokolli 6335, ët datës 27.06.2022, i ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës, me të cilin vendim i njëjti nuk është dakorduar dhe ndaj të cilit ka paraqitur ankesë mirëpo e paditura nuk ka nxjerrë vendim lidhur me ankesën e tij e për të cilën arsye me padi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë. Me anë të kërkesëpadisë, paditësi ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e tij të punës dhe të obligohet po ashtu e njëjta për kompensimin e pagave mujore nga data 27.06.2022 e deri në kthimin e tij në vendin e punës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.244/22, të datës 16.12.2022 e ka refuzuar kërkesën e të paditurës dhe është shpallur jo kompetente në këtë çështje kontestimore, me arsyetimin se gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit të provave gjegjësisht kontratës së punës, ku nga kjo kontratë gjykata konstaton se kontrata në mes të palëve ndërgjyqëse është lidhur në Prishtinë, vendi i punës së paditësit është në regjionin e Klinës dhe se në bazë të këtyre që u ceken më lartë nuk ka pengesa ligjore sa i përket kompetencës se Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore.

Kolegji i Gjykatës së Apelit pasi ka vlerësuar ankesën dhe aktvendimin e atakuar, ndonëse në aktvendimin e atakuar është dhënë këshilla juridike lejohet ankesa, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 3 të LPJK-së e lidhur me nenin 435.2 të LPK-së ligjvënësi ka paraparë: *Kundër aktvendimeve që kanë të bëjnë me drejtimin e shqyrtimit kryesor nuk lejohet ankim i veçantë.* E drejta në ankim të veçantë ndaj vendimeve me të cilat drejtohet procedura për shkak të efektit suspenziv që ka, do të ndikonte negativisht në rrjedhën dhe në shpejtësinë e procedimit dhe të zhvillimit të shqyrtimit kryesor, për këtë arsye, ligjdhënësi në paragrafin 2 të këtij neni, ka paraparë se këto vendime nuk mund të goditen me ankim të veçantë, megjithatë, palët kanë të

2023:021647

drejtë që vendimet e tilla të gjykatës ti ankimojnë së bashku vendimin mbi çështjen kryesore, andaj duke e marrë për bazë këtë normë juridike, ankesa e paraqitur nga pala ankuese është e pa lejuar dhe për këtë arsye është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu sipas nenit 387, paragrafi 1 është paraparë se " *Me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për t'u zgjidhur shpejt e drejt, gjykata që nga momenti i arritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes me aktvendim vendosë për*.. pika u) *mos kompetencën e gjykatës"* dhe përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar këtë dispozitë ligjore në paragrafin 2 të po këtij neni është paraparë se " *Kundër aktvendimeve të dhëna gjatë përgatitjes së shqyrtimit kryesor që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit nuk lejohet ankimi",* andaj në rastin konkret ankesa e të paditurës hedhet poshtë si e palejueshme.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 209, pika a), lidhur me nenin 3 të LPJK-së e lidhur me nenin 435.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.399/2023, datë 26.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj

2023:021647